

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“ OVERVIEW” SH.P.K.**

Sot, ne Tirane, me **04/02/2021.**, unë Brunilda Agron Londo me numer identifikimi ID H86222068T ,ortak i vetem, hartoj Aktin e Themelimit te shoqerise **“OVERVIEW” Sh.p.k**, sipas kerkesave te legjislacionin shqiptar ne fuqi, me dispozitat qe vijojne:

**Neni 1**

Shoqeria krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe sidomos Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare”, i ndryshuar si dhe aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate zhvillimit te veprimtarise se Shoqerise, si dhe me dispozitat e Statutit te Shoqerise qe do t'i bashkangjitet ketij Akti Themelues.

**Neni 2**

Emertimi i shoqerise eshte **“OVERVIEW” sh.p.k.**

**Neni 3**

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: **“.TIRANE,Rruga Gjon Buzuku,Godina EDAL ,Hyrja 1, Apartamenti 11”**

Transferimi i selise se Shoqerise ne nje adrese tjeter behet me miratimin e **ortakut te vetem/ asamblese se ortakeve**, i cili zoteron **100 %** te kapitalit themeltar ne momentin e krijimit te kesaj shoqerie.

**Neni 4**

Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete:

Organizim dhe menaxhim, konferencash, eventesh, seminaresh, trajnimesh etj...

Shërbime ë përkthimit. Pajisje përkthimi, mikrofoni, sisteme audio vizuale. Shërbime katering. Printime, kancelari.

Zhvillimi i aktivitetit të hoteleriturizmit, menaxhim hotelerie ,agjensi turistike, transport mallrash dhe pasagjerësh.

Organizimi trajnimeve dhe kurseve profesionale përpunesim dhe karrierë profesionale në fusha të ndryshme përsujekte private apo publike.

Sherbime konsulence në fushën juridike, financiare, marketingu, menaxhimi, konsulencë e përgjithshme biznesi për persona fizike, juridik, institucionesh tetërore, private. Sherbime ndermjetesimi tregtare, agjent tregtarej

Të kryej aktivitete publikimi, reklamimi, shitje, blerje online.

Përgatitjen, prodhimin, realizimin dhe mirëmbajtjen e faqeve të internetit dhe faqeve sociale si dhe realizimin e fushatave reklamuese.

Makina me qera, transport me automjete dhe me shofere, asistence profesionale për organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të tjera në fushen e biznesit, kulturës, sportit etj.



Pagesë e shërbimeve me xhirim bankar, me karte krediti me para në dorë, etj.  
Investime dhe pasuri të paluajtshme.

Tregtim dhe shitje me shumicë dhe pakice i produkteve ushqimore, pajisjeve industriale, elektrike, telefonike, kancelari etj..

Të kryej çdo transaksion në lidhje me pasurit e paluajtshme dhe të luajtshme si dhe cdo aktivitet tregtarfinanciar, të jap dhe të marre me qira, të vendosë pengje dhe barrahipotekore; aktivitete këto të konsiderura të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet e shoqërisë Shoqëria mund të zhvillojë çfaredo lloj aktiviteti tjetër të afert ose që lidhet me objektin e saj, e vetme ose me pjesmarrje me ente, ndërmarrje apo shoqëri të tjera, duke kryer të gjitha operacionet financiare të nevojshme për arritjen e qëllimit të Shoqërisë.

#### **Neni 5**

Kohezgjatja e Shoqërisë është përcaktuar për një periudhë **te pakufizuar kohe**.

#### **Neni 6**

Kapitali themeltar i shoqërisë është **100 000 Leke** i ndarë në **1 kuote** e e cila zotërohet nga **ortaku themelues** në masën **100%** të kuotave..

Te gjithë pjesët që formojnë kapitalin themeltar, nënshkruhen, do të shlyhen plotësisht nga **ortaku i vetem**.

Shuma e depozituar do të vertetohet me anë të një certifikate të leshuar nga Banka ku është bërë depozitimi, në të cilin shënohet emri dhe mbiemri i **ortakut të vetem, pjesa e kapitalit themeltar të nënshkruar dhe të derdhura prej tij**.

**Ortaku** ka të drejtë të bëjë zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit sipas vendimit që merr vetë ai.

#### **Neni 7**

Në marrëdhëniet me të tretet shoqëria tregëtare "**OVERVIEW**" sh.p.k. përfaqësohet nga Administratori i Shoqërisë, i emëruar **Znj, Brunilda Londo**.

#### **Neni 8**

Cdo gjë që do të kryhet parashikohet në statutin e shoqërisë, kopje e të cilit do të depozitohet në Qendren Kombëtare të Biznesit.

#### **Neni 9**

Ky Akt Themelimi është hartuar në Tiranë, me datë **04.02.2021**.

**ORTAKU I VETEM**

**Brunilda Londo**

